

# Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave **2023**





# Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4	Drenas	16
Metodologjia	5	Hani i Elezit	17
Gjetjet kryesore për vitin 2023	6	Lipjan	18
Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2023 krahasuar me indeksin e vitit 2022	10	Vushtrri	19
Buxheti i përgjegjshëm gjinor	12	Ferizaj	20
Përfundim dhe rekomandime	14	Suharekë	21
Aneks	15	Kaçanik	22
		Rahovec	23
		Dragash	24
		Malishevë	25
		Klinë	26
		Podujevë	27
		Prishtinë	28
		Shtime	29
		Istog	30
		Gjakovë	31
		Junik	32
		Deçan	33
		Gjilan	34
		Viti	35
		Fushë Kosovë	36
		Novobërdë	37
		Shtërpcë	38
		Graçanicë	39
		Mitrovicë e Veriut	40
		Mamushë	41
		Klllokot	42
		Ranillug	43

## Përmbledhje ekzekutive

Indeksi i Transparencës Buxhetore, i hartuar dhe përditësuar nga Instituti GAP që nga viti 2017, vlerëson transparencën buxhetore të komunave në Kosovë. Ky indeks synon në rritjen e llogaridhënies dhe qasjes në informacionet buxhetore në nivel lokal duke përdorur një metodologji standarde të vlerësimit për të gjitha komunat.

Ndryshe nga vitet e kaluara, në vitin 2023, transparenca buxhetore e komunave pati ndryshim negativ. Mesatarja e pikëve në vitin 2022 ishte 62.8, ndërsa në vitin 2023 kjo mesatare ka rënë në 57.5. Rënia e mesatares së pikëve në indeksin e transparencës buxhetore për vitin 2023 është ndikuar në veçanti nga problemet teknike për qasje në ueb-faqet e disa komunave. Mesataren e pikëve e kanë kaluar gjysma (50%) e komunave. Komuna e Drenasit, Vushtrrisë, Lipjanit dhe Komuna e Hanit të Elezit kanë arritur maksimumin e pikëve.

Gjatë vitit 2023, komunat kanë publikuar 207 dokumente buxhetore, shumica janë në formatet 'Excel/Word'. Nga 33 komunat e vlerësuara, 22 prej tyre kanë organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore, një komunë ka realizuar tri dëgjime, ndërsa 10 komuna nuk kanë mbajtur dëgjime buxhetore.

Dokumentet më të publikuara nga komunat ishin raporti vjetor financiar për vitin 2023 dhe rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Ndërsa dokumentet më pak të publikuara nga komunat gjatë vitit 2023 ishin kartela analitike e kontos për shpenzimet e buxhetit të vitit 2023, raporti financiar për tremujorin e dytë (TM2) për vitin 2023 dhe listat e përfituesve të subvencioneve. Bazuar në formatin e publikimit, raporti vjetor financiar 2023 dhe buxheti i planifikuar për vitin 2024 ishin dokumentet më të publikuara në formatet 'Excel/Word'. Ndërkaq, dokumenti buxhetor më i publikuar në formatin 'PDF i skanuar' nga komunat ishte raporti financiar për tremujorin e parë (TM1) për vitin 2023.

Sfidat kryesore në vlerësimin e transparencës buxhetore dhe llogaritjen e indeksit të këtij viti përfshijnë problemet me qasjen në ueb-faqet e komunave, ngadalësinë në hapjen e dokumenteve dhe mungesën e informacionit kontaktues për disa komuna në veri. Këta faktorë e kanë ndikuar negativisht nivelin e transparencës për vitin 2023.

Nga dokumentet buxhetore të kërkuara, raportin vjetor financiar e kanë publikuar 27 komuna, ndërsa kornizën afatmesme buxhetore e kanë publikuar 24 komuna. Ndërsa, në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore, 22 komuna janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 16 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

## Metodologjia

Indeksi i Transparencës Buxhetore është një raport më anë të të cilit Instituti GAP vlerëson transparencën buxhetore të komunave, duke përdorur metodologji të standardizuar për të gjitha komunat. Indeksi përditësohet që nga viti 2017 dhe synon të rrisë llogaridhënien dhe qasjen e qytetarëve në informacionet buxhetore në nivel lokal.

Ky raport përfshin vlerësimin e publikimit të dokumenteve që komunat janë të detyruara t'i publikojnë sipas legjislacionit aktual, si dhe disa dokumente të tjera buxhetore që u ofrojnë qytetarëve më shumë informacion mbi përdorimin e fondeve publike. Numri i pikëve për secilin dokument caktohet nga Instituti GAP, duke u bazuar në rëndësinë e dokumenteve buxhetore për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Komunat mund të marrin deri në 100 pikë, të ndara ndërmjet 14 dokumenteve buxhetore, si rregullore, lista të përfituesve të subvencioneve dhe dëgjime buxhetore. Vlerësimi me pikë ndryshon nga 5 deri në 20 pikë për dokument, bazuar në rëndësinë e tyre. Përveç numrit të dokumenteve, rëndësi të veçantë ka edhe formati i publikimit të tyre. Dokumentet e publikuara në formate më lehtë të lexueshme, si 'Excel' apo 'Word', marrin numrin maksimal të pikëve, ndërsa dokumentet në format 'PDF' marrin 30% pikë më pak dhe dokumentet e skanuara 50% më pak. Nëse një dokument buxhetor nuk është publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës, por është dërguar përmes email-it, atëherë pikët përkatëse ulen për 70%. Përjashtim bëjnë vetëm dokumentet si kartela analitike e kontos, kontratat e nënshkruara dhe lista e përfituesve të subvencioneve, të cilat, edhe nëse dërgohen vetëm pas kërkesës përmes email-it, nuk i humbasin pikët për 70%, pasi këto dokumente ende nuk janë obligime ligjore për publikim.

Komunat që kanë publikuar të gjitha dokumentet në faqet e tyre zyrtare në formatet 'Excel/Word' dhe kanë organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore arrijnë të marrin maksimumin e pikëve. Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat të plotësojnë një pyetësor me vegëzat e dokumenteve të publikuara në ueb-faqet e tyre zyrtare. Gjatë muajit maj 2024, Instituti GAP ka dërguar kërkesa te zyrat komunale për komunikim me publikun, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave ka përfunduar në gusht 2024, për shkak të problemeve në qasjen dhe mos-funksionimin e ueb-faqeve të komunave për disa javë radhazi. Nga 38 komunat e Kosovës, 22 prej tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 16 komuna<sup>1</sup> Onuk kanë dhënë përgjigje. Për komunat që nuk janë përgjigjur, vlerësimi është bërë në bazë të informatave të gjetura në ueb-faqet e tyre, duke përjashtuar dokumentet që nuk janë gjetur me tri klikime në fushën e dedikuar për publikimin e raporteve të buxhetit.

**Tabela 1.** Vlerësimi me pikë i komunave për publikimin e dokumenteve sipas Institutit GAP

Dokumenti	Excel/word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5	3.5	2.5	1.5
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15	10.5	7.5	4.5
Buxheti i planifikuar për vitin 2024	5	3.5	2.5	1.5
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	5	5	1.5
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10	7	5	5

<sup>1</sup> Komunat të cilat nuk kanë ofruar përgjigje në kërkesën për qasje në informacion: Gjakovë, Dragash, Fshuh Kosovë, Leposaviq, Obiliq, Prishtinë, Shtërpcë, Zubin Potok, Zveçan, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Mamushë, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klllokot.

Dokumenti	Excel/word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20	14	10	10
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5	2.5	2.5	2.5
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024–2026	10	7	5	3
Kontratrat e nënshkruara 2023	10	10	10	10
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>78</b>	<b>62.5</b>	<b>50</b>

Burimi: Instituti GAP

Për dallim nga vitet e kaluara, raporti i Indeksit të Transparencës Buxhetore për vitin 2023 përfshin vlerësimin e 33 komunave nga gjithsej 38 komuna. Problemet teknike të ueb-faqeve zyrtare të komunave kanë ndikuar që Komuna e Skënderajt, Pejës, Kamenicës, Mitrovicës së Jugut dhe Prizrenit të mos përfshihen në vlerësimin me pikë për publikimin e dokumenteve në raportin e këtij viti. Këto komuna, përmes përgjigjes së tyre ndaj kërkesës së Institutit GAP për qasje në të dhëna zyrtare, kanë shoqëruar vegëza për secilin nga këto dokumente buxhetore. Megjithatë, mosfunksionimi i ueb-faqeve të tyre e ka pamundësuar qasjen online në këto dokumente. Lidhur me këtë çështje, Instituti GAP ka kontaktuar Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), por nuk kemi arritur të marrim ndonjë përgjigje.

Përveç problemeve teknike me qasjen në ueb-faqet e komunave, për të vlerësuar transparencën buxhetore të komunave, sfidat mbeten të shumta siç janë hapja e ngadalshme e dokumenteve buxhetore e cila merr kohë deri në 10 minuta, vendosja e dokumenteve në kategori jo adekuate, mungesa e informacionit kontaktues në disa prej komunave me shumicë serbe, etj. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar që transparenca buxhetore e komunave për vitin 2023 të rezultojë më e ulët në krahasim me vitet e kaluara.

## Gjetjet kryesore për vitin 2023

Qytetarët, si taksapagues, kanë të drejtë të kërkojnë transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e fondeve publike, pasi ky informacion është thelbësor për të siguruar që taksat e tyre të përdoren në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Kjo e drejtë është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për qasje në dokumente publike. Ky ligj<sup>2</sup> lejon që qytetarët të kenë qasje në dokumentet që lidhen me shpenzimin e parasë publike dhe detyron institucionet të publikojnë këto dokumente në format elektronik dhe si të dhëna të hapura. Institucionet janë të obliguara të publikojnë çdo dokument publik të përfunduar, pavarësisht nëse qytetarët kanë bërë kërkesë për qasje ose jo. Dokumentet duhet të jenë të hapura për të ju mundësuar qytetarëve përdorimin dhe krahasimin e informatave, duke garantuar kështu transparencë dhe llogaridhënie në shpenzimin e taksave që ata paguajnë. Përveç kësaj, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike i bën përgjegjës kryetarët e komunave për publikimin e raporteve financiare në ueb-faqet e komunës dhe për organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarët. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL)<sup>3</sup> kërkon gjithashtu që komunat të mbajnë të paktën dy dëgjime publike çdo vit dhe të organizojnë takime shtesë për çështje buxhetore dhe të tjera komunale. Po ashtu, qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave<sup>4</sup> obligojnë kryetarët e komunave të shqyrtojnë buxhetin me qytetarët. Udhëzimi Administrativ i MAPL-së kërkon nga komunat të publikojnë dokumente

<sup>2</sup> [Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike.](#)


<sup>3</sup> [Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal \(MAPL\). Udhëzimi administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna. Neni 17 dhe 18.](#)

<sup>4</sup> [Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 61.](#)

buxhetore të ndryshme, përfshirë planin e buxhetit dhe planet investuese, raportet tremujore të shpenzimeve, kornizën afatmesme buxhetore (KAB), raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal, si dhe raportin e auditorit mbi buxhetin e komunës për vitin e kaluar fiskal.<sup>5</sup>

Në vitin 2023, transparenca buxhetore e komunave pati ndryshim negativ në krahasim me vitin 2022. Mesatarja e pikëve në vitin 2022 ishte 62.8, ndërsa në vitin 2023 kjo mesatare ka rënë në 57.5. Rënia e mesatares së pikëve në indeksin e transparencës buxhetore për vitin 2023 është ndikuar në veçanti nga problemet teknike për qasje në ueb-faqet e komunave. Gjithsej 20 komuna (61% e komunave) kaluan mesataren e pikëve gjatë vitit 2023, dhe katër komuna arritën maksimumin prej 100 pikësh (Komuna e Drenasit, Vushtrrisë, Lipjanit dhe Hanit të Elezit). Këto komuna kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel' ose 'Word', me përjashtim të dokumenteve me përmbajtje tekstuale që janë publikuar edhe në formate tjera si 'PDF' apo 'dokument i skanuar', por që kjo nuk i ndikon pikët maksimale. Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Suharekës gjithashtu kanë treguar një transparencë të lartë buxhetore, me 95 pikë secila. Tek të dyja komunat, uljen e pikëve nga maksimumi e ndikon mungesa e njërit prej dokumenteve buxhetore në ueb-faqen e tyre. Gjithsej, 9 komuna (27%) bëjnë pjesë në kuartilin e lartë me 83.5 pikë ose më shumë, 8 komuna (24%) në kuartilin e mesëm të lartë me 68.5 deri në 83.4 pikë, 8 komuna (24%) në kuartilin e mesëm të ulët me 25.5 deri në 68.4 pikë, dhe 8 komuna (24%) në kuartilin e ulët me më pak se 25.5 pikë.<sup>6</sup>

**Figura 1.** Indeksi i transparencës buxhetore komunale 2023



Burimi: Instituti GAP<sup>7</sup>


<sup>5</sup> Udhëzimi administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna. Neni 13 dhe neni 31.

<sup>6</sup> Kuartilet janë një koncept statistikor që përdoren për të ndarë një grup të dhënash në katër pjesë thuhajse të barabarta sipas renditjes së tyre.

<sup>7</sup> Problemet teknike të ueb-faqeve zyrtare të komunave kanë ndikuar që: Skenderaj, Peja, Kamenica, Mitrovica e Jugut dhe Prizreni të mos jenë pjesë e llogaritjeve në raportin e Indeksit të Transparencës Buxhetore për vitin 2023.

Sipas rezultateve të indeksit për transparencën buxhetore, gjatë vitit 2023, komunat kanë publikuar 207 dokumente buxhetore. Nga 33 komunat e vlerësuara, 22 prej tyre kanë organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore, një komunë ka realizuar tri dëgjime, ndërsa 10 komuna nuk kanë mbajtur dëgjime buxhetore. Listat e përfutësve të subvencioneve janë publikuar nga 22 komuna, ndërsa rregullorja për ndarjet e subvencioneve nga 27 komuna. Nga dokumentet e publikuara, shumica apo gjithsej 108 dokumente (52%) janë në formatet 'Excel/Word'. Për më shumë, 79 dokumente (38%) janë në format të skanuar dhe 18 dokumente (9%) janë në format 'PDF'. Ndërsa, prej dokumenteve të kërkuara me kërkesë zyrtare, janë pranuar vetëm dy.


**Figura 2.** Formati i dokumenteve buxhetore të publikuara



Burimi: Instituti GAP

Dokumentet më të publikuara nga komunat kanë qenë raporti vjetor financiar për vitin 2023 dhe rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Ndërsa dokumentet më pak të publikuara nga komunat gjatë vitit 2023 janë kartela analitike e kontos për shpenzimet e buxhetit të vitit 2023. Njësoj janë të publikuara listat e përfutësve të subvencioneve, raporti financiar TM2 dhe kontratat e nënshkruara. Bazuar në formatin e publikimit, raporti vjetor financiar 2023 dhe buxheti i planifikuar për vitin 2024 kanë qenë dokumentet më të publikuara në formatet 'Excel/Word'. Ndërkaq, dokumenti buxhetor më i publikuar në formatin 'PDF i skanuar' nga komunat ishte raporti financiar TM1 për vitin 2023. Rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara gjithashtu nga shumica e komunave janë të publikuara në këtë format.

**Figura 3.** Përqindja e komunave që kanë publikuar dokumentet që përmban indeksi



Burimi: Instituti GAP



Nga dokumentet buxhetore të kërkuara që të publikohen edhe me Udhëzim Administrativ të MAPL-së për transparencën komunale, 24 komuna kanë publikuar raportin financiar për TM1, 22 komuna raportin për TM2 dhe 24 komuna raportin për TM3. Raporti vjetor financiar është publikuar nga 27 komuna, ndërsa korniza afatmesme buxhetore nga 24 komuna. Dokumenti më i detajuar buxhetor, kartela analitike e kontos, e cila është vlerësuar me pikët më të larta në indeksin e GAP për transparencën buxhetore, ka qenë përsëri një nga dokumentet më pak të publikuara nga komunat, ku gjithsej 13 nga to e kanë publikuar dhe një komunë e ka përcjellur me e-mail.

**Tabela 2.** Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2023

	Excel/ word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa	Gjithsej
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	12	2	10		24
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	12	2	8		22
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	14	3	7		24
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	18	3	6		27
Buxheti i planifikuar për vitin 2024	15	2	6		23
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026	12	3	9		24
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	11		2	1	14
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10	2	9	1	22
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	4	1	22		27
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	68	4	19		91

Burimi: Instituti GAP

Duke u bazuar në formatin e publikimit të dokumenteve buxhetore, Komuna e Vushtrrisë, Drenasit, Lipjanit, Hanit të Elezit, Ferizajt, Suharekës dhe Klinës kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel/Word', duke mundësuar një qasje më të lehtë dhe përdorim më efikas të të dhënave. Këto komuna gjithashtu kanë publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara në formatin 'dokument i skanuar'. Nga ana tjetër, Komuna e Vitisë dhe Shtërpcës të gjitha dokumentet buxhetore i kanë publikuar në formatin 'dokument i skanuar', ndërsa ajo e Novobërdës pothuajse të gjitha (88%).

**Tabela 3.** Komunat që publikojnë më shumë nga dokumentet buxhetore në formatin 'excel/word' apo 'dokument i skanuar'

Komuna	Excel/Word	Komuna	Dokument i skanuar
Vushtrri	100%	Viti	100%
Drenas	100%	Shtërpcë	100%
Hani i Elezit	100%	Novobërdë	88%
Lipjan	100%		

Burimi: Instituti GAP

## Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2023 krahasuar me indeksin e vitit 2022

Indeksi i Transparencës Buxhetore Komunale për vitin 2023 tregon se komunat në Kosovë kanë pasur rezultate të ndryshueshme sa i përket transparencës. Komunat si Drenasi, Vushtrria, Hani i Elezit dhe Lipjani kanë arritur të mbajnë pozitat e tyre të para. Për Lipjanin kjo është hera e tretë që arrin pikët maksimale, ndërsa për Drenasin është viti i dytë me radhë. Hani i Elezit dhe Vushtrria, krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 janë pozicionuar nga vendi i tetë dhe i nëntë në vendin e parë.

Komuna e Kaçanikut, Mitrovicës së Veriut dhe Ferizajt kanë përmirësuar dukshëm pikët e tyre, duke u ngritur përkatësisht 16, 9 dhe 14 vende në rangim. Komuna e Ferizajt ka grumbulluar 95 pikë (24 pikë më shumë krahasuar me vitin paraprak), duke kaluar nga vendi i 19-të në të pestin. Po ashtu, Suhareka ka arritur 95 pikë (10 pikë më shumë krahasuar me vitin paraprak), duke u renditur gjithashtu në vendin e pestë. Nga ana tjetër, disa komuna, edhe pse me një dallim të vogël në pikë, janë pozicionuar më poshtë në renditje, Rahoveci ka rënë nga vendi i parë në të nëntin, me gjashtë pikë më pak. Klina me 20 pikë më pak, renditet në vendin e njëmbëdhjetë. Për dallim nga kjo, Graçanica ka pësuar një rënie të theksuar në pikë (37 më pak), ndërsa renditet në vendin e 25-të, apo dy më poshtë së në vitin paraprak.

Kjo situatë tregon se disa komuna kanë arritur të rrisin transparencën buxhetore, ndërsa të tjera përballen me sfida të mëdha që kërkojnë përmirësime.

Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për një përmirësim të vazhdueshëm në qasjen dhe transparencën e dokumenteve financiare komunale, duke përfshirë përmirësimin e cilësisë dhe qasjen në informacione që janë thelbësore për pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje dhe mbikëqyrje të buxhetit publik.

**Tabela 4.** Komunat me progresin dhe regresin më të madh në renditjen e indeksit të transparencës buxhetore

Nr. rendor	Indeksi për transparencë buxhetore komunale	Viti 2023		Viti 2022		Dallimi në pikë 2022-2023	Dallimi në rangim 2022-2023
		Pikët	Rangimi	Pikët	Rangimi		
1.	Drenas	100	1	100	1	0	0
2.	Hani i Elezit	100	1	95	8	5	7
3.	Lipjan	100	1	100	1	0	0
4.	Vushtrri	100	1	93.5	9	6.5	8
5.	Ferizaj	95	5	71	19	24	14
6.	Suharekë	95	5	85	11	10	6
7.	Kaçanik	94	7	62.5	23	31.5	16
8.	Rahovec	94	7	100	1	-6	-6
9.	Dragash	83.5	9	70	20	13.5	11
10.	Malishevë	82.5	10	70	20	12.5	10
11.	Klinë	80	11	100	1	-20	-10
12.	Podujevë	80	11	92.5	10	-12.5	-1
13.	Prishtinë	75.5	13	77	14	-1.5	1

Nr. rendor	Indeksi për transparencë buxhetore komunale	Pikët 2023	Rangimi 2023	Pikët 2022	Rangimi 2022	Dallimi në pikë 2022-2023	Dallimi në rangim 2022-2023
14.	Shtimje	75	14	65	22	10	8
15.	Istog	72.5	15	77	14	-4.5	-1
16.	Gjakovë	72	16	78.5	12	-6.5	-4
17.	Junik	68.5	17	75.5	16	-7	-1
18.	Obiliq	65	18	62.5	23	2.5	5
19.	Deçan	62.5	19	63.5	23	-1	4
20.	Gjilan	58.5	20	75	17	-16.5	-3
21.	Viti	45	21	55	27	-10	6
22.	Fushë Kosovë	41.5	22	52.5	28	-11	6
23.	Novobërdë	35	23	25	31	10	8
24.	Shtërpcë	27.5	24	22.5	32	5	8
25.	Graçanicë	25.5	25	62.5	23	-37	-2
26.	Mitrovicë e Veriut	25	26	0	35	25	9
27.	Mamushë	20	27	40	29	-20	2
28.	Klllokot	12.5	28	22.5	32	-10	4
29.	Ranillugë	12.5	28	27.5	30	-15	2
30.	Leposaviq	0	30	0	35	0	5
31.	Partesh	0	30	15	34	-15	4
32.	Zubin Potok	0	30	0	35	0	5
33.	Zveçan	0	30	0	35	0	5

Në vlerësim nuk janë përfshirë: Komuna e Skënderajt, Pejës, Kamenicës, Mitrovicës së Jugut dhe Prizrenit  
Burimi: Instituti GAP

Në aspekt të numrit të dokumenteve të publikuara, gjatë vitit 2023 dokumentet më të publikuara nga komunat ishin raporti vjetor financiar dhe rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Në anën tjetër, ato që ishin më pak të publikuara ishin raporti financiar TM2 2023 dhe lista e përfituesve të subvencioneve.

**Tabela 5.** Numri i publikimit të dokumenteve dhe dëgjimeve buxhetore nga komunat

Dokumenti	2020	2021	2022	2023
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	28	28	31	24
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	29	30	32	22
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	29	24	29	24
Raporti vjetor financiar për vitin e fundit	30	29	29	27
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	34	28	31	23
Korniza Afatmesme Buxhetore	32	29	32	24
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	32	30	30	27
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	24	20	29	22
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	7	8	14	14
Dëgjim buxhetor me qytetarë për vitin pasardhës	84	106	130	91

Burimi: Instituti GAP

## Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është një proces që synon të integrojë perspektivën gjinore në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, duke siguruar që fondet publike të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të adresojnë nevojat specifike të grave dhe burrave. Ky proces ndihmon në identifikimin dhe eliminimin e pabarazive gjinore në shpërndarjen e burimeve, dhe promovon përfshirjen më të gjerë të të gjitha grupeve në shoqëri. Në nivelin komunal, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është veçanërisht i rëndësishëm sepse komunat janë më afër qytetarëve dhe janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të rëndësishme publike si arsimit, shëndetësia, infrastruktura dhe mbrojtja sociale. Përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetin komunal ndihmon në krijimin e politikave dhe programeve që pasqyrojnë nevojat dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave, duke promovuar kështu barazinë gjinore dhe përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët. Në Kosovë, barazia gjinore është e garantuar nga Kushtetuta, por në praktikë shoqëria mbetet diskriminuese ndaj grave, si në politikë, në tregun e punës, ashtu edhe në përfitimet nga fondet publike. Sipas Ligjit Nr. 05/L-020 për barazi gjinore, institucionet e Kosovës janë të detyruara të përfshijnë buxhetimin gjinor në të gjitha këto aspekte.<sup>8</sup>

Bazuar në të dhënat e Indeksit, komunat si Deçani, Gjakova, Hani i Elezit, Istogu, Juniku, Klina, Lipjani, Podujeva, Rahoveci, Shtimja, Ferizaji, Kaçaniku dhe Vushtrria kanë qenë konsistente në publikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në vitet 2022 dhe 2023, duke treguar një përkushtim të vazhdueshëm për transparencë dhe përfshirje të perspektivës gjinore. Nga ana tjetër, komunat si Dragashi, Graçanica, Kamenica, dhe Obiliqi, të cilat kishin publikuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në vitin 2022, nuk e kanë publikuar atë në vitin 2023. Përmirësime janë vërejtur në Malishevë, ku dokumentet janë publikuar në vitin 2023, megjithëse kjo ka ndodhur pas kërkesës së Institutit GAP. Në anën tjetër, komuna si Fushë Kosova, Klllokoti, Leposaviçi, Mamusha, Mitrovica e Veriut, Novobërda, Parteshi, Peja, Prishtina, Prizreni, Ranillug, Shtërpca, Zubin Potoku dhe Zveçani nuk kanë publikuar buxhetimin gjinor në asnjë nga këto dy vite, duke treguar një mungesë të vazhdueshme të përkushtimit ndaj transparencës dhe përfshirjes gjinore.

<sup>8</sup> Ligjit Nr. 05/L-020 për barazi gjinore. Neni 3. Pika 1.17.

**Tabela 6.** (Mos)publikimi i dokumenteve për buxhetim të përgjegjshëm gjinor nga komunat

Komuna	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2021	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2022	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2023
Deçan	✓	✓	✓
Dragash	✓	✓	✗
Drenas	✓	✓	✗
Ferizaj	✗	✓	✓
Fushë Kosovë	✗	✗	✗
Gjakovë	✓	✓	✓
Gjilan	✗	✓	✗
Graçanicë	✓	✓	✗
Hani i Elezit	✗	✓	✓
Istog	✗	✓	✓
Junik	✓	✓	✓
Kaçanik	✓	✓	✓
Kamenicë	✗	✓	✗
Klinë	✗	✓	✗
Kllokot	✗	✗	✗
Leposaviç	✗	✗	✗
Lipjan	✓	✓	✓
Malishevë	✗	✗	✓ (kërkesë)
Mamushë	✗	✗	✗
Mitrovicë e Jugut	✓	✓	✗
Mitrovicë e Veriut	✗	✗	✗
Novobërdë	✗	✗	✗
Obiliq	✓	✓	✗
Partesh	✗	✗	✗
Pejë	✗	✗	✗
Podujevë	✓	✓	✓
Prishtinë	✗	✗	✗
Prizren	✗	✗	✗
Rahovec	✗	✓	✓
Ranillug	✗	✗	✗
Shtërpçë	✗	✗	✗
Shtime	✓	✓	✓
Skenderaj	✗	✓	✓
Suharekë	✗	✓	✓ (kërkesë)
Viti	✗	✗	✗
Vushtrri	✗	✓	✓
Zubin Potok	✗	✗	✗
Zveçan	✗	✗	✗

## Përfundim dhe rekomandime

Në vitin 2023, ka pasur një rënie të konsiderueshme të transparencës buxhetore në krahasim me vitin 2022. Mesatarja e pikëve ka rënë nga 62.8 në 57.5. Ky ndryshim negativ vjen kryesisht si rezultat i problemeve teknike me ueb-faqet e komunave. Lipjani, Drenasi, Vushtrria dhe Hani i Elezit janë komuna që kanë arritur pikët maksimale prej 100 dhe kanë mbajtur pozitën e tyre të para në indeks. Ndërsa, katër komuna (Leposaviq, Zubin Potok, Partesh dhe Zveçan) kanë zero pikë. Në indeksin e këtij viti përfshihen 33 nga 38 komunat e Kosovës. Problemet teknike me qasjen në ueb-faqet e komunave dhe mos-funksionimi i tyre për periudha të gjata janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar negativisht në rezultatet e transparencës. Si rrejdhojë Komuna e Pejës, Prizrenit, Mitrovicës së Jugut, Kamenicës dhe Skënderajt nuk përfshihen në llogaritjet e indeksit të këtij viti.

Numri i dokumenteve buxhetore të publikuara ka pasur rënie si dhe publikimi i dokumenteve në formate më të lehta për t'u përdorur ka rënë. Rezultatet e Indeksit të vitit 2023 nënvizojnë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm në qasjen dhe transparencën e dokumenteve financiare. Problemet me qasjen dhe cilësinë e publikimit janë faktorë që duhet të adresohen për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në nivel lokal. Ndërsa, është edhe kërkesë ligjore që të përfshihet perspektiva gjinore në buxhetim, një praktikë që ende ka shumë hapësirë për përmirësim. Përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetin komunal është thelbësore për të adresuar nevojat e ndryshme të dy gjinive dhe për të promovuar barazinë gjinore.

Për të përmirësuar transparencën buxhetore Instituti GAP rekomandon:

- Komunat duhet të sigurojnë që ueb-faqet e tyre të jenë të qasshme dhe funksionale në mënyrë të vazhdueshme;
- Publikimi i dokumenteve buxhetore në faqet zyrtare të internetit të komunave të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara edhe me Ligjin për qasje në dokumentet publike;
- Komunat duhet të publikojnë dokumentet në formate të lehta për t'u lexuar dhe shkarkuar nga përdoruesit;
- MAPL duhet të monitorojë dhe nxisë implementimin e Udhëzimit administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, konkretisht, a) për të vlerësuar nëse janë duke u publikuar dokumentet e kërkuara buxhetore nga komunat, dhe b) nëse të njëjtat janë publikuar në bazë të fushave;
- Të bëhet krijimi i seksioneve të veçanta në ueb-faqet e komunave për strukturim më të mirë të dokumenteve të publikuara;
- Komunat të angazhohen më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore dhe të publikojnë procesverbalet e dëgjimeve buxhetore;
- Komunat duhet të integrojnë perspektivën gjinore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, duke siguruar që fondet publike të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të adresojnë nevojat specifike të të gjitha grupeve gjinore.

## Aneks

Drenas	16
Hani i Elezit	17
Lipjan	18
Vushtrri	19
Ferizaj	20
Suharekë	21
Kaçanik	22
Rahovec	23
Dragash	24
Malishevë	25
Klinë	26
Podujevë	27
Prishtinë	28
Shtime	29
Istog	30
Gjakovë	31
Junik	32
Deçan	33
Gjilan	34
Viti	35
Fushë Kosovë	36
Novobërdë	37
Shtërpc	38
Graçanicë	39
Mitrovicë e Veriut	40
Mamushë	41
Kllokot	42
Ranillug	43

# Drenas

1/33

Komuna e Drenasit ka arritur maksimumin prej 100 pikësh në vlerësimin e transparencës për dokumentet e publikuara. Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, përfshirë raportet financiare tremujore për vitin 2023, raportin vjetor financiar dhe kartelat analitike për shpenzimet e buxhetit, të cilat ofrojnë detaje të hollësishme rreth shpenzimeve të komunës. Dokumente të tjera me përmbajtje kryesisht tekstuale, si rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara, janë publikuar në format PDF të skanuar.

Komuna e Drenasit i takon kuartilin të lartë dhe është përgjigjur pozitivisht në kërkesën tonë për qasje në informacion buxhetor. Ajo ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2024.

**Tabela 7.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Drenasit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2024	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024–2026	10			
Kontratat e nënshkruara 2023			10	
<b>Gjithsej</b>				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor: mungon</i>				

Indeksi:  
100



# Hani i Elezit

1/33

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur maksimumin prej 100 pikësh në vlerësimin e transparencës për dokumentet e publikuara, duke u ranguar në kuartilin e lartë. Shumica e dokumenteve janë publikuar në formatin 'Excel', përfshirë raportet financiare tremujore për vitin 2023, raportin vjetor financiar dhe kartelën analitike për shpenzimet e buxhetit, e cila është një nga dokumentet më të detajuara mbi shpenzimet e komunës. Dokumentet me përmbajtje më tekstuale, si rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara, janë publikuar në formatin 'PDF të skanuar'.

Komuna e Hanit të Elezit ka ofruar përgjigje pozitive në kërkesën tonë për qasje në informacion buxhetor dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2024

**Tabela 8.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2024	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024–2026	10			
Kontratat e nënshkruara 2023			10	
<b>Gjithsej</b>				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:  
100

# Lipjan

1/33

Komuna e Lipjanit ka arritur maksimumin prej 100 pikësh në vlerësimin e transparencës për dokumentet e publikuara, duke u ranguar në kuartilin e lartë. Të gjitha dokumentet buxhetore janë publikuar në formatin Excel, duke përfshirë raportet financiare tremujore për vitin 2023, raportin vjetor financiar dhe kartelën analitike për shpenzimet e buxhetit, e cila ofron detaje të hollësishme mbi shpenzimet e komunës. Dokumentet me përmbajtje më tekstuale, si rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara, janë publikuar në format PDF të skanuar.

Komuna e Lipjanit i është përgjigjur pozitivisht kërkesës tonë për qasje në informacion buxhetor dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2024.

**Tabela 9.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Lipjanit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2024	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026	10			
Kontratat e nënshkruara 2023	10			
<b>Gjithsej</b>				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>			✓	

Indeksi:  
100

# Vushtrri

1/33

Komuna e Vushtrrisë ka arritur maksimumin prej 100 pikësh në vlerësimin e transparencës për dokumentet e publikuara, duke u renditur në kuartilin e lartë. Të gjitha raportet financiare për vitin 2023, përfshirë raportet tremujore dhe raportin vjetor financiar, janë publikuar në format Excel. Po ashtu, dokumente të tjera si buxheti i planifikuar për vitin 2024, kartela analitike e kontos për shpenzimet e buxhetit, korniza afatmesme buxhetore 2024–2026, dhe listat e përfituesve të subvencioneve janë të qasshme në formatin Excel.

Rregullorja për ndarjen e subvencioneve është publikuar në formatin Word, ndërsa kontratat e nënshkruara për vitin 2023 janë në format PDF të skanuar. Komuna ka mbajtur katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2024 dhe ka ofruar përgjigje në kërkesën tonë për qasje në informacionin buxhetor.

**Tabela 10.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Vushtrrisë

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2024	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024–2026	10			
Kontratat e nënshkruara 2023			10	
<b>Gjithsej</b>				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:  
100

## Ferizaj

5/33

Komuna e Ferizajt ka arritur 95 pikë, duke u renditur në kuartilin e lartë për transparencë buxhetore. Dokumentet e publikuara përfshijnë raportet financiare për TM1, TM2 dhe TM3 për vitin 2023, raportin vjetor financiar për 2023, dhe kartelën analitike të kontos për shpenzimet e buxhetit për 2023 në format 'Excel'. Po ashtu, në format 'Excel' është publikuar edhe lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023. Në format 'PDF të skanuar' janë publikuar rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2023. Ndërsa, në format 'PDF' janë publikuar raporti vjetor financiar për 2023 dhe korniza afatmesme buxhetore 2024–2026.

Komuna e Ferizajt i është përgjigjur pozitivisht kërkesës sonë për qasje në dokumente publike dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2024.

**Tabela 11.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Ferizajt

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2024				
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024–2026	10			
Kontratat e nënshkruara 2023			10	
<b>Gjithsej</b>				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:  
95

## Suharekë

5/33

Komuna e Suharekës ka grumbulluar gjithsej 95 pikë, duke u renditur në kuartilin e lartë për transparencë buxhetore. Shumica e dokumenteve të publikuara nga kjo komunë janë në format 'Excel', përfshirë raportet financiare për TM1, TM2 dhe TM3 për vitin 2023, raportin vjetor financiar për vitin 2023, listën e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023, dhe kartelën analitike të kontos për shpenzimet e buxhetit për vitin 2023. Në format 'PDF të skanuar' janë të qasshme rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2023. Ndërsa ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Komuna e Suharekës i është përgjigjur pozitivisht kërkesës për qasje në dokumentet publike ku ka bashkëngjitur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

**Tabela 12.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Suharekës

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2023	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2023	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2023	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2024				
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2023	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2023	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2024	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2024–2026	10			
Kontratat e nënshkruara 2023			10	
<b>Gjithsej</b>				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor: mungon</i>				

Indeksi:  
95

## Kaçanik

7/33

Komuna e Kaçanikut ka arritur gjithsej 94 pikë dhe i takon kuartil të lartë. Ajo ka publikuar raportet tremujore TM1, TM2 dhe TM3 për vitin 2023 dhe buxhetin e planifikuar në formatin PFD, Ndërsa, raportin vjetor financiar, dhe kartelën analitike të kontos për shpenzimet e buxhetit për vitin 2023 në formatin 'Excel'. Gjithashtu, listat e përfituesve të subvencioneve, kontratat e nënshkruara dhe korniza afatmesme buxhetore 2024–2026 janë publikuar në formatin PDF. Rregullorja për ndarjen e subvencioneve është e disponueshme në formatin e skanuar.

Komuna e Kaçanikut ka ofruar përgjigje pozitive në kërkesën e Institutit GAP për qasje në dokumente dhe ka mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

**Tabela 13.** Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Kaçanikut

